



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.45/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat: Anr.45/2025 dhe Anr.47/2025 të datës 16.01.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 16.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.45/2025 dhe Anr.47/2025 nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 16 janar 2025, rreth orës 13:00, Drejtoresha e Drejtoratit për Kulturë, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Pejës, Xheneta Syka, kandidate për deputete nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës - LDK, ka organizuar takim për dhënien e çmimit "Sportisti i vitit 2024" në kohë fushate. Në këtë takim, kanë marrur pjesë edhe kandidatët e tjerë për deputetë nga LDK-ja, si: Sadri Berisha dhe Albulena Mujaj Bajraktari. Kjo e fundit, po ashtu është Drejtoreshë në Drejtorinë për Mirëqenie Sociale dhe nuk ka të bëjë fare me këtë sektor.

Fillimisht paneli pasi që shqyrtoi shkresa e lëndës gjeti se ankesat e parashtruara nga Subjekti Politik LVV, kanë njëjtësi objektive dhe gjendje të njëjtë faktike, vendosi ti trajtoj me një vendim përkatësisht ankesa e njëjtë është parashtruar dy herë dhe vendimi do të ketë numrin e ankesës së parë Anr.45/2025.

Sipas parashtruesit të ankesës, me këtë veprim LDK ka bërë shkelje të nenit 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Më tutje në ankesë theksohet se përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore. Andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si provë parashtruesit e ankesave kanë paraqitur një fotografi që dëshmon vendosjen e postierit në kundërshtim me LZP.

Më datë 14.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesat e parashtruara kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LDK, thuhet se pretendimet në ankesa nuk qëndrojnë sepse me rastin e mbajtjes së takimit për dhënien e çmimit sportist i vitit 2024, ku pjesëmarrës kanë qenë Xheneta Syka, Sadri Berisha dhe Albulena Mujaj Bajraktari, të njëjtit mbajnë edhe poste ekzekutive e legjislative për të cilat kanë përgjegjësi para qytetarëve Pejan. Po ashtu Xheneta Syka në cilësinë e Drejtoreshës së Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Pejës, ka edhe obligime të tjera për mbarëvajtje të punëve dhe detyrave të punës së përditshme në Komunën e Pejës.

Më tej në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LDK thekson se ky event i organizuar "Sportisti i vitit 2024", nuk ka të bëjë fare me fushatën zgjedhore dhe se i njëjti organizohet nga Komuna e Pejës çdo vit. Më tej në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LDK thekson se një veprim i tillë është në pajtim me LZP dhe Rregulloret Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesave, nuk mund të vërtetohet se nga ana e Subjektit Politik LDK, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje ne zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se është realizuar një tubim nga ana e Komunës e Pejës, në të cilin ka organizuar takim për dhënien e çmimit "Sportisti i vitit 2024" ku kanë marrë pjesë Xheneta Syka, Sadri Berisha dhe Albulena Mujaj Bajraktari, por nuk është i argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe bindëse se në këtë tubim është mbajtur për të promovuar Subjekti Politik LDK, ashtu siç pretendohet nga pala ankuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë nuk mund të vërehet asnjë shenjë –simbole apo materialë zgjedhor i subjektit në fjalë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se

pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.45/2025 më datën 18.01.2025

Kryesues i Panelit
Kymete Kicaj

